

KUL-TURIST

# “Bjeshkët e Nemuna” të Parisit

“Château Rouge” nuk është Parisi. Por egërsia e fillimit të kësaj lagjeje ngadalë vjen duke u zbutur. Veç pjesëve të këqija që në fillim janë më të dukshme, ngadalë fillojmë të zbulojmë edhe anët e mira. Është aty edhe një shitore lulësh, e cila i jep sharm asaj pjese të shkretuar të Parisit



“Château Rouge”



Théâtre du Rond-Point

## Jeton Neziraj

Është dhjetor, pak ditë para Krishtlindjeve. Paris. Po përpiqem të shkruaj, pavarësisht se tundimi për të parë secilin cep të Parisit është i madh. Komedia që po shkruaj, them se është e bazuar mbi ngjarje të vërteta. Flet për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës tre vjet më parë. Por, si në ata filmat komikë, që në fund shfaqin edhe disa sequenca me “gabimet” gjatë xhirimeve, edhe unë, në këtë komedi, dua të jap një perspektivë tjetër mbi atë proces, pa dyshim të rëndësishëm historik, të lindjes së shtetit më të ri në Evropë.

Doja të harroja çështjen e ambasadës, por si duket, ajo gjë më është bërë obsesion dhe them që duhet ta rrefej në krye të këtij shkrimi.

Marrja e një vize Schengen gjithnjë ka qenë një histori në vete. Ndonjëherë, gjithçka ka shkuar “kollaj”, por, në të shumtën e rasteve, fatkeqësisht, nga ambasadat kam dalë i nervozuar, i shokuar, i frustruar, i hidhëruar. Ambasadat e huaja në Kosovë ma gërditën konceptin për Evropën.

Mbasi grumbulluam një krah dokumentesh banale (certifikatë lindjeje, certifikatë familjare, certifikatë për pagim tatimi, certifikatë nga trusti pensional, kontrata e punës, vërtetim nga punëdhënësi, balancë bankare në këto tre muajt e fundit, sigurimi, dy fotografi me prapvijë të bardhë, fotokopje e pasaportës, ftesa origjinale, fotokopje e këtij dhe atij dokumenti, e dokumente e dëshmi të tjera), bashkë me gruan dhe vajzën shkuam në Ambasadën zvicerane (që i kryente shërbimet e vizave edhe për Ambasadën franceze) për të caktuar termin e vizës. Radhët e gjata para Ambasadës dhe të ftohtit më dhanë guximin t’i shkruaja një e-mail sektorit të vizave dhe t’i kërkjoja një termin të përshtetshëm. Më në fund, në terminin e caktuar, mbasi sërish pritëm në radhë të gjatë, drejtohem në sportelin numër 2. Zyrtari shqiptar, pasi trajton me kujdes dokumentet, shkon të konsultohet me zyrtarin zviceran. Ai, një flokëkaçurrel, me hundën e skuqur si spec, i frustruar kush e di se nga çka, filloi ta “trajtohte” dosjen tonë me shumë mllef. Dhe derisa ai llototiste pa lidhje e me ton fyes, unë “ëndërroja” sa sa mirë do t’ishte sikur t’mund t’ia ngjisja për fyti dhe t’ia bëja llom atë fytyrë t’urruer burokrati.

## Château Rouge

Nga aeroporti “Paris-Charles de Gaulle” deri në “Gare du Nord” udhëtojmë me trenin RER. Sipas ud-

hëzime të mëhershme, në dalje të “Gare du Nord” na pret Dominique Dolmieu, drejtor i MEO-s (Shtëpisë së Evropës dhe Orientit). Në metro, vajza ime katërvjeçare Anina, që si duket për herë të parë pa një grua zezake, u kthye nga ne dhe na pyeti me kureshje prej fëmije: çfarë ka në fytyrë kjo grua? Ne, natyrisht i vumë në siklet. U munduam t’ia shpjegojmë me fjalë të bukura, se “njerëzit janë të ngjashëm, por lëkurat e tyre mund të kenë ngjyra të ndryshme”.

Banasa jonë ku do të jetonim javët e para ishte në “Château Rouge”, një lagje prej atyre “të varfrave” të Parisit. Por, para së gjithash, kjo rrugë ishte e njohur për shkak të prezencës së madhe të komuniteteve nga Afrika. Thjesht, “lagje e drejtë dhe t’birin”. Lagjja, herët në mëngjes, para se t’fshihet nga pasturesit, duket sikur pas rënies së ndonjë bombe. Gjendje gjithçka e hedhur pakujdes, lëvore pemësh, perime të kalbura, qese najloni, kanaçe, shishe birrash e shumëçka tjetër. Kutërbonte më keq sesa edhe tualetet e Teatrit Kombëtar të Kosovës. Ishte lagje e frikshme, megjithatë. Kaq shumë zezakë kisha parë vetëm në Gomma të Kongos. Atje isha tronditur nga ajo varfëri dhe atmosferë tmerrri që dominonte qytetin. Kur pas kthimit, njerëzit që më pyesnin, u thosha se ishte “vend i pashpresë”.

“Château Rouge” nuk është Parisi. Ato dekorime të bukura dhe ato manirët ‘alla franceze’ të Krishtlindjeve, në këtë lagje mungojnë.

Natën, pas orës 23:00, të gjitha skutat e lagjes mbushen me prostituta zezake, të cilat rrinë mbështetur për mure ndërtesash a për dyer garazhesh. Rrinë kryesisht vetëm, por ndonjëherë edhe nga dy. Nuk janë agresive dhe si duket, target kryesorë kanë zezakët. Disa nga to duket të mbajtura mirë, por ka edhe të trasha, të cilat zor se gjejnë myshterinj.

Megjithatë, egërsia e fillimit që na dhuroi lagjia ngadalë vjen duke u zbutur. Veç pjesëve të këqija që në fillim janë më të dukshme, ngadalë fillojmë të zbulojmë edhe anët e mira. Është aty edhe një shitore lulësh, e cila i jep sharm asaj pjese të shkretuar të Parisit.

Banasa ku rrimë është e mbajtur mirë dhe pronarët janë një çift artistësh. Gruaja është fotografe nga Serbia. Epo, tekefundit, askush nuk është i përsosur. Disa që, këto kohët e fundit, si me llupë i kanë përcjellë bashkëpunimet e mia me artistë serbë, do të zbulojnë edhe me këtë rast idetë konspirative. Epo, për dreq, predispozitat ekzistojnë: se nuk u gjet në tërë Parisin një banesë tjetër,

por kjo e një artisteje serbe! Phu, ç fat i quditshëm që më ndjek edhe mua!

E ndërkohë që ditët dhe netët palosen njëra-mbi tjetrën, një mbrëmje Anina vendos t’i kthehet atij zanatit të saj të vjetër. Gërvisht me laps njërin prej skajëve të kauçit dhe pastaj krenare na thërret ta shohim marifetin e saj. Ne shokohemi. Në shtëpinë tonë ajo ka pasur kufizimet se çka mund të bëjë e çka jo. Por si duket, tash në këtë ambient të ri, ato kufizime i janë zgjeruar vetvetiu. Ne tani “djersitemi” duke bërë plane se si t’ia bëjmë. A mund t’i eliminojmë ato vija? Si mund t’i eliminojmë? A duhet ta njoftojmë pronarin? A mos ndoshta mund të blejmë ndonjë llak pa ngjyrë e ta rregullojmë atë pjesë? A mos do të na duhet të paguajmë për dëmin? Dhe kështu, pa ide e meditime pa fund. Ato vija shërri mbesin si njolla turpi, si duket, për të na kujtuar atë logjikën shkatërrimtare që na atribuonjë neve ballkanasve. Thuhet se, kur dy ballkanas erdhën për herë të parë në Paris dhe panë Kullën e Ajfelit, ata u mrekulluan dhe menjëherë filluan ta pyesin njëri-tjetrin: a thua, sa kilogramë dinamit duhen që kjo ngrehinë e madhe metali të shembet?

## Shtëpia e Evropës dhe e Orientit

Ditët e para të dhjetorit më është dashur të shkoja në MEO gati çdo mbrëmje. MEO ishte një hapësirë e ngrohtë që të bënte të ndiheshë si në shtëpi. Është më tepër sesa mrekulli kur sheh aty libra të përkthyer nga gjuhët që ndoshta as që i ke dëgjuar se ekzistojnë. Njerëzit në MEO janë mikpritës. Po, vërtet mikpritës. Prezantimet e dramave të autorëve shqiptarë, të programuara për datat 5-9 dhjetor, kalojnë për mrekulli. Publiku vjen rregullisht dhe në numër të madh. Në njërin prej prezantimeve e shohim që “mbin” aty ministri kosovar i Diasporës, Ibrahim Makolli. Pritet me respekt dhe i bëhet çareja në atë masë publiku.

Atyre ditëve shoqërohem me shkrimtarin francez, Gilles Boulan, edhe ai në rezidencë të MEO-s. Me Gilles komunikojmë në anglisht. Frëngjishtja ime është e trishtueshme, por edhe anglishtja e Gilles është e vështirë.

Dominique Dolmieu, me të cilin njihem që nga viti 2002, është vazhdimisht aktiv. Unë thjesht e admiroj energjinë e tij dhe këmbëngulësinë e tij për të mos u dorëzuar para telasheve. Ai është “njeri i pakompromis deri në pakompromis”.

Në MEO e takoj natyrisht edhe Arben Bajraktarajn. Arbeni është pa dyshim njëri prej aktorëve më të suksesshëm shqiptarë në Evropë. Karriera e tij si aktor filmi ka pasur përparime marramendëse. Arbeni ka bashkëpërkthyer “Bregun e pikëlimit” të Teki Dervishit, që është njëra prej dramave që prezantohen atyre netëve në MEO. Arbeni, tash së fundi, ka përkthyer edhe dramën time “Shembja e Kullës së Ajfelit”, e cila, njëjtë, u prezantua në MEO, në serinë e prezantimeve të dramaturgjisë shqipe.

Diku nga fundi i dhjetorit, në një të premtë me shi, e vizitohet Ambasadën e Republikës së Kosovës. Takohem me ambasadorin Muhamedin Kullashi dhe me Lulëzim Hisenin, sekretar i parë në Ambasadë. Në Ambasadë pata një pritje jashtëzakonisht të përzemërt. Ishte hera e parë që e takoja ambasadorin Kullashi, edhe pse kisha lexuar shumë nga shkrimet e mprehta të tij. Biseda, natyrisht, u soll rreth punës së Ambasadës, rreth zhvillimeve kulturore në Kosovë, por, pak më vonë flasim edhe për konceptin e faljes dhe të pajtimit në kontekstin ballkanik. Ambasadori është tejet preciz në analizat e tjera. Inggur deri në fyt me atë diskursin patriotiko-folklorik që dominon në Kosovë, sa herë që flitet për çështjet e ndjeshme si këto që kanë të bëjnë me faljen e pajtimit, biseda me ambasadorin Kullashi më bën mirë.

## Théâtre du Rond-Point

Ditë më parë kisha dëgjuar, por pa kuptuar shumë, për një shfaqje e cila paska nxitur reagimet e integralistëve të krishterë. Kapja tek - tuk ndonjë fjalë, por s’kisha arritur të krijoja një ide se për çka në fakt bëhej fjalë. Më 15 dhjetor, bashkë me një mikun tim aktor, Simon Pitaqaj, u gjendëm përballë grupit të vogël të protestuesve dhe përballë barrierave policore e hekurishteve që ishin vënë në rrugë për të bllokuar hyrjet për në teatër ku po jepej shfaqja “Golgota picnic” e regjisorit nga Buenos Aires, Rodrigo Garcia. Disi u përbirua nëpër kordonët e policisë dhe erdhëm përballë teatrit, ku një rresht i gjatë priste para hyrjes. Të sigurt se nuk do të gjenim bileta, vendosëm që së paku të hynim në teatër dhe të hanim darkë në restorantin brenda. Pritja në rresht, në shiun e imët por insistues, u bë e mërzitshme. Rreshti i gjatë lëvizte ngadalë përpara ndërtesës, ku pastaj secili kontrolluaj në detaje, madje, më rreptë sesa kontrollimet nëpër aeroporte. Për befasinë tonë, megjithatë u gjetën dy bileta për shfaqjen dhe ne e gjetëm veten të

ulur në rreshtin e parë të teatrit të bukur.

Shfaqja ishte e mrekullueshme, provokuese deri në ekstrem, madje shokuuese. Dhe para së gjithash, inteligjente. E tërë sipërfaqja e skenës ishte e mbuluar me bukë sandviçi. Dikush që kishte bërë një matematikë të thjeshtë, tha se bëhej fjalë për 24 mijë sandviçë. Pra, 24 mijë për çdo reprizë të shfaqjes. Si një ballkanas i “untë”, i ardhur nga një kulturë ku përbuzja e bukës është si njëllaj sakrilegjë, nuk ishte shumë e lehtë të cilët luhej këtë dalldisje regjisoriale skenike. Si themi ne “i ngiti kurrë nuk ia di të untit”! Gjatë shfaqjes, mendja kohë pas kohe më fluturonte në rrugët e Gommas në Kongo. Kujtoja turmat e mëdha të fëmijëve me stomakë të fryrë që hanin shkopinj të kallëm-sheqerit. Tani, i ndodhur përballë atyre 24 mijë sandviçëve me të cilët luhej siç luan plazhisti me kokrat e zallit në plazh, ishte diçka që e përceptoja me shumë vështirësi. Por, përtej këtyre ngarkesave kulturore e fetihiste për bukën, shfaqja, vërtet ishte e shkëlqyeshme.

Javët e fundit të qëndrimit në Paris, zhvendosemi nga “Château Rouge” në Montruil. Asociacioni i parë lingvistik i kësaj lagjeje të Parisit është me Montreuilin e Kanadasë. Disi, kisha përshtypjen që kjo në fakt nuk është një paralagje e Parisit, por një qytet në vete. Megjithatë, u befasova për të mirë. Nga Montreuil deri në çdo stacion tjetër më në qendër të Parisit vihej shumë lehtë. Udhëtonim deri në Nation, e prej aty gjithandej. Shtëpia ku banonim tani ishte e shkëlqyeshme. Pronarët, një çift fantastik, na pritën vetëm natën e parë dhe pastaj udhëtuan jashtë vendit. Ne rrinim në katin e dytë, që kishte një sallon të bukur, një dhomë gjumi, dhomë pune, e natyrisht, një kuzhinë e një banjë. Ishte ngrohtë dhe, aq më tepër, rryma nuk ndalej asnjëherë. Sado që ishim të lumtur që kishim rrymë vazhdimisht, na brente nga pak frika e kthimit në shtëpi, ku do të na prisnin ndalesat e rrymës. Kjo i ngjasonte asaj historisë së atij burrit që ka pasur frikë nga fluturimi me aeroplan. Njëherë, ai hip në aeroplan dhe shkon diku për pushime. Megjithatë, pushimet i shndërrohen në tmerr nga frika e kthimit mbrapsht me aeroplan.

Ky shkrim i shkurtër është pjesë e një shkrimi më të gjatë me përshkrim nga qëndrimi dymujor në rezidencën për shkrimtarë në Paris. Rezidenca u organizua nga Maison d'Europe et d'Orient (Shtëpia e Evropës dhe e Orientit) përmes një granti nga Ile-de-France.